

VENDIM
Nr.186, datë 17.3.2010

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT DHE PËR PËRBËRJEN E
KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE
EKONOMIKE JOBUIJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 202, datë 17.12.2009 "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore", me propozimin e Ministrisë të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Qendror i Regjistrimit të Njësive Ekonomike Jobujqësore kryesohet nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- a) Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- b) Ministrin e Financave;
- c) Ministrin e Brendshëm;
- ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Statistikave;
- d) Drejtorin e Drejtorisë së Statistikave Ekonomike në INSTAT;
- dh) Drejtorin e Drejtorisë së Llogarive Kombëtare në INSTAT;
- e) Drejtorin e Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
- ë) Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- f) Dekanin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës;
- g) Drejtorin e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri.

2. Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore mbledhet çdo muaj. Mbledhjet e tij kryesohen nga kryetari i Komisionit e, në mungesë të tij, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Mbledhjet e këtij Komisioni do të zhvillohen në mjediset e Kryeministrit.

3. Në mbledhjet e Komisionit, veç anëtarëve, marrin pjesë edhe specialistët e nevojshëm sipas specifikës së çështjes, që do të diskutohet, në përputhje me vendimin që është marrë, paraprakisht, nga Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore.

4. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës së Komisionit Qendror të Regjistrimit të Njësive Ekonomike Jobujqësore propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it. Thirrja e mbledhjeve kryhet me anë të një njoftimi, i cili duhet t'i transmetohet çdo anëtar të komisionit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar në njoftimin për mbledhje. Në njoftim përcaktohen data, ora e mbledhjes dhe rendi i ditës. Njoftimi shoqërohet me materialet, që do të shqyrtohen në mbledhje, të përgatitura nga sekretariati i Komisionit, pasi të jetë marrë, paraprakisht, miratimi nga kryetari i këtij Komisioni.

5. Mbledhjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore e deklarohen të hapur kryetari i Komisionit, pasi ka verifikuar nëse në mbledhje marrin pjesë mbi 50% e anëtarëve. Për të gjitha çështjet, që diskutohen në mbledhje, vendoset me votim me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Për çdo mbledhje të komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore mbahet procesverbal, i cili zbardhet nga sekretariati i Komisionit brenda pesë ditëve nga data e mbledhjes. Në procesverbal përcaktohen, ndërmjet të tjerave,:

- numri dhe tematika e mbledhjes;
- data, koha e fillimit dhe mbylljes së mbledhjes;
- emri i drejtuesit dhe i sekretarit të mbledhjes;

- emrat e anëtarëve të pranishëm;
- rendi i ditës;
- rezultatet e votimit.

7. Detyrat dhe kompetencat e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore janë të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 10 202, datë 17.12.2009.

8. INSTAT-i ngarkohet me detyrën e sekretariatit të Komisionit dhe ka këto detyra:

- Njoftimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, për mbledhjen e radhës;

- Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes;

- Përgatitjen e dokumentacionit bazë të mbledhjes;

- Përgatitjen dhe dërgimin e kryetarit të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore të dokumentacionit për mbledhjen e këtij komisioni;

- Njoftimin e shpërndarjen e rendit të ditës, të projektakteve që do të shqyrtohen dhe të dokumentacionit, për mbledhjen e radhës, anëtarëve, brenda dy ditëve nga data e nënshkrimit nga kryetari;

- Mbajtjen e kopjeve të dokumentacionit, që do të shqyrtohet në mbledhje, dhe vendosjen e tij në dispozicion të anëtarëve;

- Përgatitjen e projektit të procesverbalit, të projektvendimeve të marra në mbledhje dhe ndjekjen e procedurave të miratimit e të arkivimit të tij;

- Përgatitjen e vendimeve që do të merren, në përputhje me rendin e ditës, të cilat ia bashkëngjit procesverbalit, të nënshkruar nga anëtarët.

9. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha